



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Arben Fetoshi
Drejtore
Radio Blue Sky
R003a
Rr/ Nëna Terezë p.n.
Prishtinë

VENDIMI: LIC/KPM-2013/13
Ref:1302/373/KPM/mi

VENDIM

*në lidhje me kërkesën e Radio Blue Sky për ndryshimin e emrit në Radio Kosova 2
(Radio Kosova 2-Programi i Dytë)*

Fakte

1. Radio Blue Sky, është Transmetues Publik me mbulim nacional me seli në Prishtinë, e cila është pajisur me licencë afatgjatë të Komisionit të Pavarur për Media (KPM), më 28 gusht 2009.
2. KPM, me datën 11 janar 2013, ka pranuar kërkesën nga drejtore i Radio Kosovës z. Arben Fetoshi për ndryshimin e emrit nga Radio Blue Sky në Radio Kosova 2.

Arsyetim

3. Kërkesa për ndryshimin e emrit të Radio Blue Sky në Radio Kosova 2, është bazuar sipas modelit të transmetuesve publik evropian dhe i bazuar gjithashtu në Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës, i cili e përcakton përbërjen e RTK-së me dy kanale të Radio Kosovës.
4. Kërkesa për ndryshim të emrit të Radio Blue Sky, nuk paraqet asnjë ndryshim tjetër në Pakon e Licencës së KPM-së për këtë radio stacion.
5. Emri i propozuar Radio Kosova 2, për t'u identifikuar në të ardhmen si radio stacion në Republikën e Kosovës, nuk është i ngjashëm me asnjë nga emrat e


subjekteve transmetuese të licencuara nga KPM, që operojnë në Republikën e Kosovës, dhe si i tillë nuk paraqet ndonjë problem lidhur me identifikimin e radio stacionit nga ana e dëgjuesve.

Vendim

6. Komisioni i Pavarur për Media, konkludon që ndryshimi i emrit të Radio Blue Sky në Radio Kosova 2, nuk paraqet ndryshime të tjera të licencës.
7. Komisioni i Pavarur për Media, merr vendim që Radio Blue Sky t'i lejohet ndryshimi i emrit në Radio Kosova 2.

Lëshimi i Vendimit

8. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur për Media.


Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



15.02.2013
datë